

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrestohet kushëri i Ergys Agasit, Eno Agasi
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/arrestohet-kusheriri-i-ergys-agasit-eno-agasi/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:13:27 UTC Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:09:01 UTC Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	34147510a223698e609274ccae335f2ce25e61c74e973ae331e0750fe5ba2ade
TEKSTI	1067008903e1b842e25b03c6033696495a646e9c04cb0c7c628c7adecbbff376
PAMJA	6e3c38aa30a47188dc2344ea054c5016f50d4d4124df4da738f6383858ec075b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4066acae9ee23666159e8e54c6b46640d62a05b044bdd98770f3fc3ca636dc56
E MËPARSHMJA	a9d176ea7aa998a4939695e8cc2b0b27bc3ef6c91065d7c8a28fc38c65d1fc3e
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4066acae9ee23666159e8e54c6b46640d62a05b044bdd98770f3fc3ca636dc56>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Arrestohet kushëriri i Ergys Agasit, Eno Agasi

19:09 : 16/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Eno Agasi, kushëriri i **Ergys Agasit**, është arrestuar pas rreth **tetë muajsh në arrati**, pasi ishte shpallur në kërkim nga drejtësia.

Sipas raportimeve në media, Eno Agasi është arrestuar te Kodra e Diellit teksa po lëvizte me automjet. Ai ishte në kërkim pasi Gjykata e Tiranës kishte caktuar ndaj tij masën e sigurisë “arrest në burg”, i akuzuar për pastrim parash dhe veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës.

Eno Agasi dyshohet se ka lidhje me **zhdukjen e shisheve të shtrenjta të verës**, të cilat ishin sekuestruar nga SPAK në dhjetor të vitit 2025, gjatë operacionit ku u shpall në kërkim kushëriri i tij, Ergys Agasi.

Pas sekuestrimit, vera ishte inventarizuar dhe ishte lënë në një kantinë, pasi për shkak të orarit të vonë nuk mund të transportohej nga autoritetet doganore. Megjithatë, kur punonjësit janë rikthyer të nesërmen për ta marrë, **shishet e verës nuk janë gjetur më në ambientet e kantinës**.

Pikërisht për këtë ngjarje, Eno Agasi dyshohet se ka ndërmarrë veprime që kanë penguar zbardhjen e plotë të rrethanave të çështjes, ndërsa ndaj tij vijon hetimi edhe për **pastrim parash**.

Lexo edhe:

[Shisin kokainë në lokal, arrestohen tre persona në Elbasan](#)

[40 vjedhje në banesa, arrestohen 4 shqiptarë në Itali](#)

Ndërkohë, Ergys Agasi, një prej personave të shpallur në kërkim nga SPAK në kuadër të dosjes së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), **u arrestua më 26 gusht**, në Durrës dhe u la në burg nga GJKKO.

Në momentin e arrestimit, Agasi udhëtonte me një automjet tip “Audi”, së bashku me ish-zyrtarin e Policisë së Elbasanit, Uljan Shpataraku. Ky i fundit u arrestua gjithashtu dhe u la në burg nga GJKKO pasi akuzohet për “Përkrahje të autorit të krimit”.

TË GJITHA



Dita e 109-të e protestës/ Thirrje për UÇK-në gjatë marshimit në Tiranë

19:41 : 16/09/2026



109-të ditë revoltë/ Protestuesit drejt Kryeministrit, paralajmërojnë mosbindje civile

19:34 : 16/09/2026



Institucionet e drejtësisë kundërshtojnë projektligjin për pagat e magistratëve

19:30 : 16/09/2026



5 orë në SPAK/ Del nga Prokuroria e Posaçme arkitekti tjetër i vilës së Ballukut

19:24 : 16/09/2026



Vuçiç i pakënaqur me vendimin e Hagës: Mos festoni ende

19:18 : 16/09/2026



Të shtënat me armë në Durrës, kush është avokati i plagosur /EMRI

19:13 : 16/09/2026



Arrestohet kushëriri i Ergys Agasit, Eno Agasi

19:09 : 16/09/2026

Ergys Agasi ishte shpallur në kërkim prej dhjetorit të vitit të kaluar, në kuadër të hetimeve të SPAK për një grup të dyshuar kriminal që lidhet me manipulimin e tenderave të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Etiketa: arrestim Eno Agasi Ergys Agasi

Lajme të lidhura



Shisnin kokainë në lokal, arrestohen tre persona në Elbasan

17:08 : 16/09/2026



40 vjedhje në banesa, arrestohen 4 shqiptarë në Itali

20:19 : 15/09/2026



Sekuestrohen 20 kg drogë në Austri, dy të arrestuar, mes tyre një shqiptar

20:04 : 15/09/2026



Wifi dhe alkool/ SPAK aksion blic në sektorin ku mbahet Ergys Agasi

15:47 : 15/09/2026



Arrestohet në Spanjë 64-vjeçari shqiptar me 46 precedentë penal

13:12 : 15/09/2026



Dhunuan barbarisht indianin, arrestohen dy shqiptarët në Greqi

21:21 : 14/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.